



Rruga "Vaso Pasha", pas "Kinema Agimi"  
Pallati Nr.24, Kati V-të, Ap. 13  
1019 Tiranë, Shqipëri  
[citizens.al](http://citizens.al)

Datë: 28/11/2024

## KËRKESË

**KËRKUES:** Erblin Vukaj  
**DREJTUAR:** Bashkisë Pukë  
**PËR DIJENI:** Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, Erin Neziri  
**OBJEKTI:** Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni  
**BAZA LIGJORE:** Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>I</sup>, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>II</sup>; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike<sup>III</sup>; Ligji "Për Statusin e Nëpunësit Civil"<sup>IV</sup>; Ligji "Për të drejtën e informimit"<sup>V</sup>; Gjykata Kushtetuese<sup>VI</sup>

Të nderuar drejtues të Bashkisë Pukë,

Erblin Vukaj dhe Citizens.al, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/informacioneve zyrtare në lidhje me ndotjen e lumit Drin (Drini i Bardhë, Drini i Zi, kaskada e Drinit apo rrjedha e tij drejt Adriatikut), rolin e bashkisë në menaxhimin e mbetjeve përgjatë lumit, projektet konkrete për pastrimin dhe rehabilitimin, fondet e alokuara për pastrimin e mbeturinave, përmirësimin e infrastrukturës mjedisore etj.

Më konkretisht:

Citizens.al po punon për të kryer një raportim ndërkufitar për situatën e lumit Drin sa i takon nivelit të ndotjes, ndërhyrjeve urbane etj. për këtë duam të vihemi në dijeni për pyetjet/kërkesat si më poshtë:

1. A janë identifikuar vend-depozitime të paligjshme mbeturinash përgjatë një rrjedhe të lumit Drin (Drini Bardhë, Drini Zi, Kaskada e Drinit, apo rrjedha drejt Adriatikut) në territorin e bashkisë suaj?
2. Çfarë masash janë marrë për pastrimin dhe mbajtjen e lumit të pastër?
3. A ka bashkia juaj një strategji për ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e mbrojtjes së lumit?
4. A ka plane për krijimin e stacioneve të trajtimit të ujërave të zeza në fshatrat/zonat urbane pranë lumit Drin në territorin tuaj?

*Citizens Channel promovon gazetarinë qytetare dhe fuqizimin e zërave të përgjegjshëm, në përputhje me vlerat e një shoqërie gjithëpranuese dhe tolerante, në respektim të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.*

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetem në pritje të përgjigjes suaj!  
Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në numrat apo adresën elektronike të poshtëshënuar.

Me respekt  
Erblin Vukaj  
Gazetar

ERBLIN VUKAJ

**Email:** [erblinvukaj@gmail.com](mailto:erblinvukaj@gmail.com)

**Mobile:** +355 69 7474 096

**Web:** <https://citizens.al/>

i Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Neni 23):

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

ii Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni 10 “Liria e shprehjes”):

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysht kufijtë.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen etë dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

iii Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Neni 19):

1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.
2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.
3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t’u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:
  - a. Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;
  - b. Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik

iv Ligji Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (Neni 19 “Detyrat”): Nëpunësit civilë kanë këto detyra:

- a. Të sigurojnë për publikun e gjerë, palët e interesuara dhe institucionet publike, informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur ky informacion është sekret shtetëror, konfidencial ose për përdorim të brendshëm në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore.

v Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (Neni 3 “E drejta e informimit”):

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje tjetër në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit [...]

vi Vendimi Nr.16 i datës 11/11/2004 i Gjykatës Kushtetuese:

---

*“E drejta e informimit, ndër elementet e saj kryesorë ka lirinë personale për të marrë informacion, lirinë personale për të dhënë informacion dhe lirinë e shtypit, ose thënë ndryshe, të drejtën e medias për të marrë e dhënë informacion. Kjo e fundit trajtohet gjithnjë si e drejtë më vete, për shkak të rolit të veçantë që luan media në një shoqëri të lirë e demokratike. Pozicioni i “privilegjuar” i medias në shtetin demokratik garantohet për shkak se është pikërisht ajo, që e bën pushtetin shtetëror më të prekshëm për njerëzit, më të kontrollueshëm dhe më transparent. Media ndikon që individët e angazhuar në të tre pushtetet, si persona të zgjedhur apo zyrtarë, të kenë disa cilësi të reja. Ata janë më afër me median, më të komunikueshëm me njerëzit, më të kujdesshëm në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre si dhe në jetën e angazhimit e tjera shtetërore e private. Media është gjithashtu një bazë e rëndësishme për të kontrolluar dhe gjykuar se si funksionarët e veshur me pushtet, ushtrojnë autoritetin publik dhe si i menaxhojnë fondet publike. Garantimi i lirisë së medias, ndër të tjera, zvogëlon mundësinë e manipulimeve me pushtetin publik si dhe nxit identifikimin e rasteve korruptive. Arma e saj më e fuqishme është kritika e vazhdueshme ndaj dukurive negative që rrezikojnë demokracinë si formë e qeverisjes. Në dallim nga Konventa Evropiane të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozitatë veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj. Liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton, edhe garantimin e lirisë së shprehjes, lirinë e shtypit dhe të drejtën e informimit si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.”*